REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 140/17, 144/17
Data/Datum 12.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit **UP-UNIVERSITETI I PRISHTINËS.**	Kopje:	**Paneli Shqyrtues - OSHP**
Prej:	**Sabrije Bullatovci-Eksperte Shqyrtuese** **Besim Mulaj – Ekspert Teknik.**		
Lënda:	Ekspertiza Lidhur me Ankesat: **Nr. 140/17 e OE "Besa Security" – Prishtinë,** **Nr. 144/17 e OE "Security Code" – Prishtinë,**		
Datë:	**12.06.2017**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesat e parashtruar me Nr. **140/17** parashtruar nga OE **"Besa Security" – Prishtinë** dhe ankesën me Nr. **144/17** parashtruar nga OE **"Security Code" – Prishtinë**, për shqyrtimin e lëndës: **" Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës'' me nr. te prokurimit 90400/17/002/211 (numri i brendshëm) 242-17-88-2-1-1 (numri ne forme elektronike)** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UP-UNIVERSITETI I PRISHTINËS.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **UP- UNIVERSITETI I PRISHTINËS.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"Besa Security" – Prishtinë**
- OE ankues -- **"Security Code" – Prishtinë,**

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bujladaci		**29.05.2017**		**30.05.2017**		**12.06.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 12.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **140/17** te parashtruar nga **OE"Besa Security"** – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës'' me nr. te prokurimit 90400/17/002/211 (numri i brendshëm) 242-17-88-2-1-1 (numri ne forme elektronike)** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UP-UNIVERSITETI I PRISHTINËS.**

Me datën 18.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **144/17** te parashtruar nga **OE "Rojet e Nderit"** – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës'' me nr. te prokurimit 90400/17/002/211 (numri i brendshëm) 242-17-88-2-1-1 (numri ne forme elektronike)** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **UP-UNIVERSITETI I PRISHTINËS.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Eksperti Shqyrtues-Teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) - **UP-UNIVERSITETI I PRISHTINËS.**

Pikat e Ankesës nga OE: **"Besa Security"** – Prishtinë - *dispozitat e shkelura nga AK:*

Dosja e tenderit

Aneksi I I dosjes se tenderit

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ne baze te dosjes se tenderit (FDT), eshte kerkuar qe per 3 vitet (2014, 2015, 2016) te kete te perfunduar kontrata me vlere 3 milion euro. Besa Security ka paraqitur keto kontrata te cilat kane qene 1 vjeçare, dhe te njejtat Besa Security i ka fituar çdo vit. Per te njejtat Besa Security ka pranuar kerkese per sqarim nga AK UP dhe per te njejtat i ka derguar kontratat nje nga nje, si dhe vlerat e faturave per çdo muaj, ne periudhen Janar 2014 deri me Dhjetor 2016.

- Ne takimin e dates 03.05.2017 ne zyret e prokurimit te UP-se, eshte kjartesuar se per keto kontrata Besa Security ka ofruar kontrata te cilat e kane permbushur kete kriter. Gjegjesisht vlera totale e tyre per 3 vite eshte 3,250,033€.

Gjithashtu, ne baze te Dosjes se Tenderit dhe Aneksit 1, Besa Security ka bere kalkulimin e çmimit per ore per nje roje fizike, duke ia garantuar rojeve pagen 250 euro bruto sipas oreve te rregullta pergjate vitit. Pastaj, jane shtuar edhe pagesat shtese per oret e nates, te cilat jane nxerre nga oret totale te pikave 24h apo 48h, gjegjesisht te pikave te cilat kane ore te nates, dhe jane pjesetuar me 3. Vlera e dale eshte shumezuar me diferencen e kostos per ore nate.

Gjithashtu, shumave te lartecekura i'u eshte kalkuluar diferenca per oret e pushimeve vjetore, ne baze te numrit te rojeve. Oret e punes per roje shtese jane shumezuar me çmimin per ore sipas pagave te rojeve tjere.

Gjithashtu, shumave te lartcekura i'u eshte kalkuluar diferenca per oret e festave vjetore, ne baze te kalendarit te festave ne faqen zyrtare. Oret e festave jane shumezuar me diferencen e kostos per ore feste.

Gjithashtu, shumave te lartcekura i'u eshte kalkuluar vlera e uniformave ne baze te specifikacionit te dorezuar me tender.

Ne fund, eshte llogaritur TVSH dhe ka dalur çmimi 2.05Eur/h.

Vërejtje: Kalkulimet jane bere ne baze te te dhenave te plota sipas tabeles se paraqitur nga AK UP andaj vlera eshte e sakte dhe precize. Kalkulimi eshte bere me ndihmen e kontabilistit tone te jashtem z.Xhemail Syla, i cili eshte edhe auditor financiar.

- Ne baze te Raportit te Komisionit te Vleresimit, shihet se per kete pozicion, Besa Security eshte bere jo e pergjegjshme me arsyen qe nuk eshte kalkulimi i qarte, pa kerkuar kjartesime shtese ne kete drejtim dhe duke e bere nje vleresim sikur te mos kishte te dhena totale per te gjitha pikat, eshte pse pjese e DT-se ka qene edhe Analiza Financiare per çmimin e ofertuar.

Ju lutemi shiqoni kalkulimin si eshte bere nga ne, i cili eshte i aprovuar nga kontabilsti z.Xhemail Syla, i cili ka pervoje ne kontabilitet mbi 35 vjecare.

	Përshkrimi i shërbimit/objektët	Njësia matëse orë	nr I diteve ne jave			**DDP,EURO -** TOTAL
1	Rektorati	24	7	8760	1.50862069	13,215.52
2	Rektorati roja dites	9	5	2346	1.50862069	3,539.87
3	Rojet levizese ne hapsirat UP	96	7	35040	1.50862069	52,862.07
4	Fakulteti I mjeksise	72	7	26280	1.50862069	39,646.55
5	Fakulteti I mjeksise parkingu	9	5	2346	1.50862069	3,539.87
6	fak. Makinerise dhe ndertimtarise	24	7	8760	1.50862069	13,215.52
7	fak. Teknik	48	7	17520	1.50862069	26,431.04
8	fak. I SHMN	72	7	26280	1.50862069	39,646.55
9	Fak. Filozofik	24	7	8760	1.50862069	13,215.52
10	Fak. Filologjik	24	7	8760	1.50862069	13,215.52
11	Fak. I Arkitektures	24	7	8760	1.50862069	13,215.52
12	Fak. Ekonomik/juridik	48	7	17520	1.50862069	26,431.04
13	Fak. I Edukimit	48	7	17520	1.50862069	26,431.04
14	Fak. I Arteve	48	7	17520	1.50862069	26,431.04
15	Fak. I Arteve diten	8	5	2086	1.50862069	3,146.55
16	fak. I bujqesise	48	7	17520	1.50862069	26,431.04
17	Fak. I kultures fizike	24	7	8760	1.50862069	13,215.52
18	parkingu fak. Ekonomik/jurudik	11	6	3441	1.50862069	5,191.81
19	rampa te fak. Filologjik	12	5	3129	1.50862069	4,719.83
20	administrata qendrore	8	5	2086	1.50862069	3,146.55
21	Bibloteka universitare	24	7	8760	1.50862069	13,215.52

22	Bibloteka universitare recepcioni	8	5	2086	1.508620 69	3,146.55	
23	Fak. Arteve Muzika	24	7	8760	1.508620 69	13,215.52	
	Pune nate			81760	0.452586207	37,003.45	
	Pushim vjetor	20 dit pune	126 roje	2520	1.508620 69	3,801.72	
	Festat	11.6 dite		7899.6	0.754310345	5,958.75	
	Kosto e uniformave dimer vere	sipas specifikacionit te paraqitur, pjestuar per 3 vite					11,505.00
	Kosto Tjera (Policat: Sigurimi I tenderit, egzekutimit, etj.)					2,500.00	
	Fitimi I parashikuar					200.00	
		Gjithsejtë:		262800		457,434.46	
				Ore Totale		262,800	
						1.74	
					18% tvsh	0.31	
						2.05	

VEREJTJE; TE GJITHA SHPENZIMET JANE NDARE NE BAZA VJETORE. NDERTIMET E OREVE JANE BERE NE BAZE TE OREVE DITORE DHE PUNES JAVORE

Prandaj, nje veprim i tille i Autoritetit Kontraktues nuk respekton dispozitat e LPP, dhe permes kesaj ankese ne kerkojme qe te kthehet tenderi ne rivleresim dhe te shpallet fitues OE K.S. Besa Security Sh.p.k., si tenderi i pergjegjshem me çmimin me te ulet.

Megjithate, ne lusim OSHP qe te bene analizimin e tabeles sone te paraqitur ne baze te dhenave te Dosjes se Tenderit dhe te konkludoni qe:
Te aprovohet kerkesa e OE Besa Security mbi baze te fakteve te paraqitura te cilat jane vleresuar detajisht nga OSHP, dhe lenda te kthehet ne rivleresim tek AK.

N.111,LPP – Ankesa me nr. 144/17 nga OE "Rojet e Nderit" – Prishtinë

Pikat e Ankesës nga OE: **"Rojet e Nderit"** – Prishtinë - *dispozitat e shkelura nga AK:*

Njoftimi për kontratë/**KRPP – 06.02.2017**
Dorëzimi i Ofertave/**UP – 20.03.2017 ora 14:00**
Hapja e Ofertave/**UP – 20.03.2017 ora 14:00**
Njoftimi për dhënie të kontratës/**E-Prokurimi - 01.05.2017**
Letër standarde për tenderusin e pasuksesshëm/**UP – 28.04.2017**
Kriteri për dhënie të kontratës: **Çmimi më i ulët**
Kërkesa për Rishqyrtim/**AK - 03.05.2017**
Përgjegja përmes e-mailit/**AK – 15.05.2017**

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 7, par. 1, nën-paragrafin (vi) të paragrafit 6 të LPP-së Rregullorja për Prokurimin Publik Neni 17, par. 1
Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 59, par.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 60, par. 1 të LPP-së

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

***Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur:**
- **Nenin 7 par. 1 të LPP-së,** Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
- **Neni 7 nënparagrafi (vi) të par. 6 ku thotë: <u>që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.</u>**

***Sipas Rregullores për Prokurim Publik Neni 17 par. 1** thotë:
Autoritetet kontraktuese mund të përdorin vetëm kërkesa, kritere dhe specifikacione të publikuara ose parashtruara në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së tenderëve dhe dhënies së kontratës. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit.
-Ku sipas këtyre pikave: <u>Vetëm</u> kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftimin për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.
-Në dosjen e tenderit tek <u>Ankesi 1, Specifikimet teknike të detyrueshme</u> të lëshuar nga UP të gjithë OE ju keni cekur kriteret si më poshtë:

Kompani është e obliguar që të respektoi pagën mujore minimale në shum prej 250 € bruto(Me te gjitha taksat e aplikueshme ne RKS) duhet te parashihet edhe ndrrimi i natës, pushimi vjetorë, si të drejta elementare nga Ligji i Punës 03/L-212, oferta duhët të këtë të kalkuluar edhe çminin lidhur me uniformat e punës (dimrore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.
OE janë të obliguar të paraqesin analizën finaciare duke përfshir të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.
-Në pyetjet dhe përgjigjet për sqarim shtesë kemi pranuar informacione rreth kalkulimit të ofertës tonë, ju keni cekur si më poshtë:
Ju lutem na sqaroni çështjet te cilat i kemi ngritur më poshtë:

1. Forma e dorëzimit të tenderit:

PYETJE: Dorëzimi i dosjes a mund të bëhet në mënyrë fizike, apo vetëm në formën elektronike?
PËRGJIGJE: O.E.duhet të zgjedhin formen e dorëzimit të ofertave elektronike ose fizike.

2. FDT dosja e tenderit, Neni 9.1 & 9.1, kërkesa nr. 7: OE duhet të dëshmoj se posedon të gjitha lejet dhe apo licencat për përdorim të pajisjeve të punëtorëve në territorin e Kosovës.

PYETJE: Sipas Ligjit për Shërbimet Private të Sigurimit Fizik, kompania e cila është e licencuar për shërbimet të sigurimit fizik, nuk kërkohet të posedoj ndonjë licencë apo autorizim shtesë për përdorim të mjeteve të punës në territorin e Kosovës. Për çfarë licence apo autorizim bëhet fjalë?

PËRGJIGJE : Kërkohet vetëm raport nga ana e O.E.

3. FDT dosja e tenderit, Neni 9.1 & 9.2, kërkesa nr. 9 Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkohet shuma e kontratave në vlerën prej 3,000,000.00 euro.

PYETJE: A mund të ofrojmë dëshmi qarkullimin bankar të kompanisë, për të vërtetuar vlerën e shërbimeve për tri vite, apo vërtetim nga ATK, i cili është dëshmi më e besueshme.

PËRGJIGJE: Nuk mundet të ofrohet. O.E. duhet ti përmbahen kërkesës në dosjen e tenderit

4. Aneksi 1 Specifikimet teknike të detyrueshme, kërkohet: "Kompani është e obliguar që të respektoi pagën mujore minimale në shumë prej 250 € bruto (Me te gjitha taksat e aplikueshme ne RKS) duhet te parashihet edhe ndërrimi i natës, pushimi vjetorë, si të drejta elementare nga Ligji i Punës 03/L-212, oferta duhet të këtë të kalkuluar edhe çmimin lidhur me uniformat e punës (dimërore dhe verore si dhe fitimin e parashikuar të OE.
OE janë të obliguar të paraqesin analizën financiare duke përfshirë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

PYETJE:

- Ju lutem na saktësoni se cilat kritere kërkohen ne llogaritjen e pagës se punëtorit?
  A duhet të kalkulohen vetëm kriteret të cilat ju i keni theksuar (kontributet dhe tatimet përfshirë edhe TVSH, pushimet vjetore, ndërrimet e natës), apo duhet të llogariten edhe kriteret tjera të cilat i parasheh ligji si:
  - Kontributin 5 % të punëdhënësit, dhe dispozitat tjera ligjore si:
  - Orët e punës gjatë natës
  - Orët e punës gjate vikendit
  - Orët e punës gjatë festave zyrtare
  - Pushimet vjetore 20 ditë pune
  - Pushimet mjekësore, nëse po, sa ditë pushimi mjekësor duhet të llogariten?

Poashtu nuk keni sqaruar se kërkesat e tilla a duhet të përfshihen në kuadër të pagës prej 250 €, apo mbi pagën prej 250 €.
JU LUTEM NA SQARONI ME GJERESISHT.
Kërkojmë qe te na dërgoni një formulë (tabelë), e cila do të jetë standarde dhe unike për të gjithë OE të cilët marrin pjesë në këtë procedurë tenderuese, për mënyrën e llogaritjes së pagës, konform kërkesave tuaja.

PËRGJIGJE: Në kuadër të pagës 250 € duhet të përfshihen Kontributi i punëmarrësit dhe tatimi ne burim, të tjerat kalkulohen mbi kete vlere.

- Kontributin 5 % të punëdhënësit,
- Orët e punës gjatë natës
- Orët e punës gjatë festave zyrtare
- Pushimet vjetore

5. Kërkesa për përfshirjen e uniformës në kalkulimin e çmimit:

PYETJE: Sa i përket uniformës, ju njoftojmë se kompania ka për obligim sigurimin e uniformës për punëtor.
Uniformat nuk janë unike për të gjithë OE, çmimi i tyre mund të varioj dhe si i tillë, nuk mund të jetë kriter i njëjtë matës në përcaktimin e çmimit total për të gjithë OE.
Kërkojmë na AK ta largoj këtë kriter nga kriteret e përcaktuara për llogaritjen e çmimit.
Uniforma futet ne koston e shpenzimeve bashkë me shpenzimet tjera për ekzekutimin e kontratës, kosto të cilën OE duhet ta kalkuloj në tërësi, jo vetëm shpenzimin e uniformës. Poashtu këtë kosto OE e përfshinë në çmimin e përgjithshëm bashkë me fitimin e paraparë.

PËRGJIGJE: Referoju dosjes së tenderit.

Pyejte 1:
Kur të llogaritim pagën minimale në nivel bruto 250€, d.m.th. që **paga bazë është 250€** për orarin e rregullt të ditës (orët e ditës), kurse në këtë pagë duhet të shtohen të gjitha detyrimet konform Ligjit të Punës në fuqi **Nr. 03/L-212** (ndërrimet e natës plus 30%, festat zyrtare plus 50%, trusti pensional 5% nga punëdhënësi dhe pushimet vjetore), por a duhet të merret parasysh edhe Udhëzimi Administraiv i MPMS **Nr. 09/2013** i cili saktëson saktë sasinë e orëve (174 orë) për një punëtorë në muaj për pagën bazë?
Përgjigje1 :

Po duhet të kalkulohen (174 orë)në baze të Udhëzimit Administraiv i MPMS Nr. 09/2013

Pyetja 2:
Në faqen 42 të dosjes së tenderit është një tabelë ku duhet të pasqyrohen çmimet për uniformë verore dhe dimrore, që të jemi sa më transparent të gjitha kompanitë që ofertojnë a duhet të dokumentojmë çmimit e uniformës me fakturën e fundit të blerjes së tyre dhe duke bashkangjitur fletpagesën e bankës si dëshmi (pasi që uniformat mund të variojnë me çmime të ndryshme dhe kushti është që të gjitha kompanitë duhet të llogarisin dhe të inkorporojnë shpenzimet e uniformës në çmimin për orë) ?!
Përgjigje 2 :
Po duhet të bashkangjitur faktura dhe fletëpagesa e bankës.

- Me vetë faktin që ju i keni cekur këto kritere, ju keni bërë shkelje, pasi që OE që është shpërblyer me kontratë nuk e plotëson këtë kriter.

***Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 59 par .4 të LPP-së,** Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
- Me çrast ju keni bërë shkelje pasi që OE i shpërblyer me kontratë ashtu siq e kemi cekur më lartë nuk duhet të jetë i përgjegjshëm pasi që kriterin e kërkuar për paga dhe Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 nuk i ka plotësuar.

***Supozohet se AutoritetiKontraktueskashkelurNenin 60 të LPP-së par.1,** Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:
1.1 tenderin **e përgjegjshëm** me çmimin më të ulët;
- Këtë e themi pasi që OE i shpërblyer me kontratë dukshëm nuk është i përgjegjshëm dhe në mënyrë mjeshëtrore i ka ikur kalkulimeve të sakta (jepni vëmendje kalkulimeve të numërave pas presjes dhjetore dhe mesataren e orëve të punës – orët e ditës, orët e natës dhe të festave) për qëllimin që në fund të del me çmim më të lirë se OE e tjerë për kriterin e DT-Çmimi më i ulët duke e vënë në lajthitje AK-UP. Për këtë ne shprehim besimin tonë në drejtësin e Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe kërkojmë nga ky organ që të zhvillojë seancë në të cilën do ti konstatoj shkeljet e AK dhe pas kësaj të nxjerrë vendim meritor-ta detyroj AK – UP që ti rrespektoj kriteret e DT para se të merrë vendime të tilla jo meritore për këtë aktivitet të prokurimit, për arsye të ndryshme jo të parapara në Ligjin Nr.04/L-042 për PPRK, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, dhe të RIVLERËSOJ këtë aktivitet të prokurimit, pasi që në mënyrë të qartë janë shkelur kriteret dhe nën kriteret e përcaktuara në DT.

Vërejtje: Jepni vëmendje të veçant çmimit të uniformës për OE-Rojet e Nderit (36.70€) dhe OE-Security Code (31.32€) dmth në koston e uniformës jemi më të lire dhe për çudi Rojet e Nderit në total janë dalë me çmim më të ulët!

- **Provë:**
  1. **Analiza Financiare**
  2. **Faturat e uniformave të OE – Rojet e Nderit dhe Security Code**

ANALIZA FINANCIARE

Për përmbushjen e kërkesës së AK për pagën **250€** Bruto të kërkuar duhet të i shtohet 5%(12.50€) e trustit pensional dhe pastaj të filloj kalkulimet tjera,dmth 262.50€ pjestuar për 174 orë=1.5086€,ora e dites.

1	Paga Bazë Bruto për punëtor e kërkuar nga AK-UP	**250.00€**
2	Tatimi për kontribut pensional nga punëdhënësi 5%	**+12.50€**
3	Shenzimet për pagen 250 bruto e punëtorit me trust pensional	**=262.50€**

1	Përqindja për një muaj për pushimin vjetor për të cilin kompania është e detyruar ti jap punëtorit me pagesë sipas nenit 32 të Ligjit Nr.03/L-212.	**21.875€**	Shpenzimet Bruto për një punëtor jan **262.50€** pjestur për **12 muaj**(një vitë) na del vlera e shpenzimeve mujore për një

				punëtor për pushim vjetor.
2	**109** orë të dites mesatare për një muaj.	**1.5086€x109** orë =**164.4374**		**Ora e dites.**
3	**59** orë të nates mestare për një muaj.	**1.95€x 59**orë =**115.05€**		**Ora e nates.**
4	**6** orë të festave mesatare në muaj .	**2.25€x 6** orë = **13.50€**		**Ora e festes.**
5	**174 orë fondi i orëve për një punëtor.**	**174orë**		Sipas Ligjit në fuqi dhe Udhëzimit Adminstrativ **MPMS Nr.09/2013** dhe kerkeses se AK-UP.
6	Totali i kostos më të gjitha obligimet .		**313.925€**	**Pa tvsh vetëm për mbulimin e pagave dhe pushimin vjetor.**
7	Fitimi i kompanisë.		**0.10€**	Fitmi për një punëtor.
8	Shpenzimet për uniform –Verë/Dimer.		**2.61€**	Çmimi i uniformës të komp."**Security Code**"është **31.32€** pa TVSH pjestuar për **12 muaj** .
9	Totali pa tvsh.		**317.5724€**	
10	Vlera e TVSH.		**57.1631€**	Çmimi i ofertuesit PLUS 18% TVSH.
11	Oferta e OE e pjestuar për 174 orë pune		**374.7355€**	Për një punëtor 174 orë pune.
12	Qmimi për një orë pune/njësi.		**2.1536€**	
13	Totali i pergjegjeshum i ofertes më tvsh.		**1,538,187.26€**	**2.1536€**(një orë pune) **x 714240 orë pune.**

Festat zyrtare brenda një muaji për një punëtor	
Festat zyrtare në RKS 12 ditë brenda një viti	288 orë
Mesatarja një festë në muaj pjestuar per 4 Roje	24orë
Orët e punës për një punëtor	6orë
Çmimi ores të dites+ 50 % sipas LP neni 56 për festa zyrtare	2.25€
Shpenzimet për një punëtor për orët e nates për një muaj	13.50€

Netët brenda një muaji për një punëtor			
Kosto e Pagës bazë për një punëtor me 5% trust pensional te punedhenesit	262.50	244orë	8 Orë nate herë mesatarja e një muaji 30+31/2=30.5ditë minus një feste=29.5 ditë
Orët e punës për një punëtor	174	236orë	29.5 herë 8 orë nate=236 orë e natës pjestuar për 4 Roje=59 orë të nates
Çmimi për një orë pune të dites	**1.5086€**	59 Orë	Zbritja sipas paragrafit 3 8 ,6 orët e festave paguhen me 50% jo me 30%
Çmimi ores të dites + 30 % sipas LP neni 56		**1.95€**	Orët e natës për një punëtor
Shpenzimet për një punëtor për orët e nates për një muaj	115.05€		

Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit"i shpallur fitues ka oferuar në total **Shumen 1,535,616.00€** kurse shpenzimet reale simbas kekeses se AK-UP-s jan **1,538,187.26€** që kur e bejm ndryshimin na del se OE"Rojet e Nderit"jan nen qmim dhe të pa pergjegjeshum për **Shumen - 2'571.26€ në total.**

*Oferta e **OE "Rojet e Nderit"***	***1,535,616.00€***
Kostoja e pergjegjeshme për mbulimin e kerkes se AK për të gjitha obligimet ndaj punetoreve	**1,538,187.26€**
Vlera që OE"Rojet e Nderit"është nen pagat për të qen i pergjegjeshum ndaj kekesave te AK-UP	- *2,571.26€*

*Oferta e **Security Code"shpk***	**1,538,472.96€**
Kostoja e pergjegjeshme për mbulimin e kerkes se AK për të gjitha obligimet ndaj punetoreve	**1,538,187.26€**
Vlera jon që na del së jemi në plus dhe të pregjegjeshum simbas kerkese se AK-UP	***+285.70€***

Prishinë 18.05.2017	*OE "Security Code" shpk*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	)17
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedure e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Shërbim / vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë 17 ditë):.....	15.03.2017
Data e hapjes së ofertave	15.03.2017-14:00h
Kriter për dhënie të kontratës:.....	*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*
Lloji i kontratës:.....	*Kontratë kornize – 36 muaj*

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (Neni 60):
Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët

III.2. – KUSHTET PER PJESEMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa 1: Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.
Kërkesa 2: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
Kërkesa 3: Vërtetimin nga Gjykata themelore -Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një document ekuivalent të lëshuar nga një autoritet competent gjyqësor apo administrativ i shtetit.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe I vulosur nga O. Ekonomik
Evidenca 2: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal
Evidenca 3: Vërtetimin nga Gjykata themelore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratësorigjinal

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesa 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit
Kërkesa 2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së
Kërkesa 3. Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit
Evidenca 2. Kopja e Certifikatës e TVSH-së
Evidenca 3. Kopja e Certifikatës me numër fiskal (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar
Kërkesa
Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj se ne tri vitet e fundit 2014,2015,2016, ka pasur qarkullim me kontrata(Te përfunduara 2014,2015,2016) per sigurim fizik 3,000,000.00€,
Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Kopjet e kontratave se bashku me referenca perkatese

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë sigurimit themelor ,Licenca nga MPB,autorizim
2. Licenca e leshuar nga ART per perdorimin e frekuencave per mjete komunikimi;
3.Licenca per sigurimin e tubimeve publike;
4. Licenca e e vezhgimit elekronik të pronës, Çertifikata e qendres se kontrollit certifikata ,licence;
5. Leja e punes e lwshuar nga Autoritetet pwrkatwse komunale;
6. OE duhet te jete i çertifikuar sipas ISO 9001-2008;
7 .Një raport mbi mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicion të Operatorit ekonomik për kryerjen e shërbimit të sigurimit fizik. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se posedon së paku: sistemin e ndërlidhjes për komunikim të brendshëm (aparatet për komunikim të dorës dhe aparatet fikse për komunikim), mjetet dhe paisjet e punës për punëtoret (shufrat, prangat, ndriçueset, etj.).Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj së posedon të gjitha lejet dhe apo licencat për per përdorimin e ketyre paisjeve ne territorin e Kosoves;
8. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit

Dëshmia e kërkuar dokumentare
1.Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB(per roje fizike) dhe autorizimi për nisjen fillestare të veprimtarive të lëshuara nga MPB, sipas Ligjit për Shërbimet Private te Sigurisë nr. 04/L-004; (valide)
2. Licenca kopje e leshuar nga ART për përdorimin e frekuencave për mjete komunikimi (valide)
3. Licenca kopje për ushtrimin e veprimtarisë së tubimeve publike (valide)
4. Licenca kopje për vezhgimin elektronik të pronsis,dhe kopja e çertifikates se Çendres se Kontrollit (valide)
5. Leja e punës kopje e leshuar nga autoritetet perakatese komunale ku Operatori Ekonomik ka seline. (valide)
6. Kopja e çertifikatws ISO 9001-2008 (valide)lemin e sigurimit
7. Një raport mbi mjetet, stabilimentet dhe paisjet teknike që janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik për kryerjen e shërbimit të sigurimit fizik. Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se posedon së paku: (aparatet për komunikim të dorës dhe aparatet fikse për komunikim), mjetet dhe paisjet e punës për punëtoret (shufrat, prangat, ndriçueset, etj.). Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj së posedon të gjitha lejet dhe /apo licencat për per përdorimin e ketyre paisjeve ne Territorin e Kosoves.
8. OE duhet të ofroj një deklaratë për caktimin e menaxherit të projektit, të bashkangjitur CV

III.3.5 - Kërkesat për sigurim të tenderit

Vlera e sigurisë: **22,000.00 €**, euro
Vlefshmëria: me afat prej 120 ditëve

III.3.6 - Sigurimi i ekzekutimit
Vlera e sigurisë: 10 % të vlerës së kontratës
Vlefshmëria: 37 muaj pas nënshkrimit të kontratës

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatori ekonomik	Selia e OE-s	Çmimi i ofertës/në euro
1	ROJET E NDERIT	Prishtinë	1,535,616.00
2	ALPHA SECURITY	Prishtinë	1,514,189.00
4	SECURITY CODE	Prishtinë	1,538,472.96
5	BESA SECURITY	Prishtinë	1,464,196.00

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin e Rivleresimit pas vendimit te OSHP-së nr. 248/16 dhe 258/16 në përbërje prej pesë anëtarëve, si në vijim:

1.Dardan Krasniqi-Drejtor i Administrates-Gjuhë dhe Letersi Gjermane - Kryetar i komisionit,
2.Muharrem Arifi-Drejtor i Depart.te Likuidimit-Ing.dip.Elektroteknikes- Anëtar i komisionit,
3.Skender Hasani-Kryesues i Njësise për Kontroll dhe Mbikqyrje-ekonomist-Anëtar i komisionit,
4.Valon Fetahu-Zyrtar i Fondeve dhe Financave-Ekonomist- Anëtar i komisionit,
5.Shefik Kurteshi-U.D. i Drejtorit te Departamentit Ligjor-Jurist-Anëtar i komisionit.

Data e mbarimit të vlerësimit: 18.04.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....18.04.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....20.04.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	ROJET E NDERIT	Prishtinë	1,535,616.00
2.	SECURITY CODE	Prishtinë	1,538,472.96

Raporti i komisionit vlerësues:
Pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave komisioni e ka rekomanduar per kontratë OE: "Rojet e Nderit".

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, me vlerë të madhe, **kontratë për Shërbim**, dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

PERGJIEGJET E EKSEPRTIT TEKNIK NE LIDHJE ME PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES me nr. 140/17 e OE **"Besa Security"** – Prishtinë

Sqarimi nr.2

Se pari mund te konstatojmë se OE Besa Security nuk i është referuar fare LPP dhe asnjë neni te caktuar se cilat janë shkeljet e ndonjë neni qe e kane dëmtuar ne ketë rast përveç se ka cek dosja e tenderit dhe Aneksi II i dosjes se tenderit,por vetëm ka elaboruar lidhur me shkeljet e mundshme te AK.

Pika e ankesës lidhur me kriterin e njoftimit për kontrate dhe dosjes se tenderit ku është kërkuar decidivisht kështu,citat:

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet te dëshmoj se ne tri vitet e fundit 2014,2015,2016, ka pasur qarkullim me kontrata(Te përfunduara 2014,2015,2016) për sigurim fizik 3,000,000.00€,

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Kopjet e kontratave se bashku me referenca përkatëse.

Ne ketë rast AK ka vlerësuar mbi bazën e dokumenteve te dorëzuara nga OE ankues dhe gjate vlerësimit kane kërkuar sqarime shtese nga ky OE sepse nuk kane mundur me e përcaktua qarkullimin e OE sipas dëshmive te ofruara, sipas shkresave te lendes ka ofruar sqarime lidhur me kontratat si dhe dëshmitë nga programi i tyre i kontabilitetit lidhur me qarkullimin financiar,por kërkesë e AK ka qene qe qarkullimi brenda tri viteve (2014,2015 dhe 2016) te dëshmohet me kontrata te përfunduara si dhe te ofrohen edhe referencat.

OE ankues ka ofruar sqarimet por përmes tyre nuk mund te vërtetohet qarkullimi sepse sipas shkresave te ofruara me date 11.04.2017 vërehet se ky OE nuk ka sqaruar si duhet ketë kërkesë,po ju ofroj si dëshmi (emalin e datës 11.04.2017 te OE drejtuar UP) por edhe sqarimet shtese te datës 07.06.2017 qe janë sjellë ne forme fizike pas kërkesës nga eksperti ku është e qarte se ky OE ka disa kontrata te cilat sipas prezantimit janë kështu :

1. Raiffesisen Bank – 01.04.2012-vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje.
2. Banka për Biznes –Prill 2012-vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje ,
3. KEP Trust – 01.12.2015-vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje,
4. Komuna e Ferizajt – 15.08.2014-15 Shkurt 2017,
5. ProCredit Bank – 01.11.2015-vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje.

Eksperti teknik me date 06.06.2017 përmes emalit ka kërkuar sqarime shtese nga OE ankues për ti sqaruar me shume kontratat dhe referencat lidhur me qarkullimin financiar sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe me date 07.06.2017 OE i ka sjellë dëshmitë shtese ne forme fizike.

Edhe pas sqarimeve te ofruara ky OE nuk ka arrit te na siguroj lidhur me qarkullimin financiar,me poshtë po japi një sqarim sa me detal lidhur me këto kontrata te prezantuara:

1.Raiffesisen Bank – 01.04.2012-vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje:

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata e ofruar ne mes te **OE dhe Raiffessen Bank është e nënshkruar me date 01 Janar 2015** dhe vazhdon deri me date 31 Mars 2016,kjo kontrate nuk ka vlere te caktuar por vetëm çmim ne njësi dhe atë për shërbime te ndryshme dhe jo siç është kërkuar vetëm për sigurim fizik si dhe ka sjellë raport financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë por qe këto shuma nuk mund te dihen se për cilat shërbime mund te jene ne ketë rast.

Shuma e paraqitur sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është **571,321.20 Euro.**

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata tjetër e ofruar ne mes te **OE dhe Raiffessen Bank është e nënshkruar me date 31 Janar 2013 deri me date 08 Shtator 2014**,kjo kontrate nuk vlere te caktuar bile as çmim ne njësi pa cekur për llojin e shërbimit sepse është kërkuar vetëm për sigurim fizik si dhe ka sjellë raport financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë por qe këto shuma nuk mund te dihen se për qfar shërbimi mund te jene ne ketë rast.

Shuma e paraqitur sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është **835,984.21 Euro** por qe nuk dihet se cilat janë shumat për sigurim fizik (sepse kjo kontrate ka te përfshira edhe shërbime tjera si "CMC monitoring officers" -Zyrtarët e monitorimit të CMC-së),po ashtu nëse marrim periudhën 2014,2015 dhe 2016 te kjo shume atëherë na del se faturimi për periudhën 2014 ne ketë rast është **rreth 400,000.00 si shume qe mund te llogaritet ne periudhën qe kërkohet ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit.**

Vlen te ceket se për këto dy kontrata ka ofruar një reference e cila nuk ka vlere .

Vlera e kontratës se pare e cekur me larte edhe pse nuk mund te identifikohet për cilin shërbim behet fjale sipas periudhës se kërkuar ne dosje te tenderit është rreth **400,000.00 euro ndërsa vlera për kontratën e dyte edhe pse nuk mund te identifikohet lloji i shërbimit dhe as vlera mund te themi për periudhën e kërkuar vlera e kësaj kontrate është 571,321.20 euro.**

2. Banka për Biznes –Prill 2012-vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje.

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata e ofruar ne mes te **OE dhe BPB-Banka Për Biznes është e nënshkruar me date 19.04.2013 me afat për një periudhe dy vjeçare,**ky aneks kontrate është nënshkruar duke u bazuar ne kontratën baze D509 e datës 03.04.2012 për sigurimin fizik,dhe kontratën tjetër baze D508 date 03.04.2012 e cila është për shërbime te transportit te parave te cilat nuk kane vlere te caktuar por vetëm çmim ne njësi dhe atë për shërbime te ndryshme dhe jo siç është kërkuar vetëm për sigurim fizik si dhe ka sjellë raport

financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë por qe këto shuma nuk mund te dihen se për cilat shërbime mund te jene ne ketë rast.

Shuma e paraqitur sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është **626,130.15** Euro por qe nuk dihet se cilat janë shumat për sigurim fizik (sepse kjo kontrate ka te përfshira edhe shërbime tjera si shërbime te transportit te parave),po ashtu nëse marrim periudhën 2014,2015 dhe 2016 te kjo shume atëherë na del se faturimi për periudhën 2014,2015 dhe 2016 ne ketë rast është **rreth 400,000.00 si shume qe mund te llogaritet ne periudhën qe kërkohet ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit edhe pse edhe kjo shume nuk mund te identifikohet sa a është për shërbime te sigurimit fizik siç është kërkuar ne dosje te tenderit.**

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata tjetër e ofruar ne mes te **OE dhe BPB-Banka Për Biznes është e nënshkruar me date 31.03.2015 deri me date 27.01.2016**,kjo kontrate nuk ka vlere te caktuar por vetëm çmim ne njësi si dhe ka sjellë raport financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë , shuma për ketë kontrate sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është **185,121.87 euro.**

Vlen te ceket se për këto dy kontrata ka ofruar një reference e cila nuk ka vlere te caktuar.

Vlera e kontratës se pare e cekur me larte edhe pse nuk mund te identifikohet për cilin shërbim behet fjale sipas periudhës se kërkuar ne dosje te tenderit është rreth **400,000.00 euro ndërsa vlera për kontratën e dyte për periudhën e kërkuar është 185,121.87 euro.**
Vlera e dy kontratave te paraqitura se bashku është 400,000.00 + 185,121.87 = 585,321.20 euro.

3. KEP Trust - 01.12.2015 - vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata e ofruar ne mes te **OE dhe KEP Trust është e nënshkruar me date 01.12.2015 deri me date 30.11.2016** ,kjo kontrate nuk ka vlere por vetëm çmim ne njësi prej 1.68 euro për ore ,OE ankues ka sjellë raport financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë.

Shuma e paraqitur sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është **154,478.77** .

Vlen te ceket se për ketë kontrate ka ofruar një reference e cila është e datës **04.08.2016** qe do te thotë se referenca është e lëshuar para se te përfundon shërbimi gjë qe nuk mund te merret parasysh kjo kontrate sepse shërbimi sipas kontratës duhet te përfundon me date **30.11.2016** .

1. **Komuna e Ferizajt - 15.08.2014 - 15 Shkurt 2017,**

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata e ofruar ne mes te **OE dhe Komunës se Ferizajt është e nënshkruar me date 14.08.2014 deri me date 14.08.2016** , OE ankues ka sjellë raport financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë.

Shuma e paraqitur sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është **161,688.93** .

Vlen te ceket se për ketë kontrate ka ofruar një reference e cila është e datës **27.11.2014** pra rreth tre muaj pas nënshkrimit te kontratës **(sqarim kontrata ka përfunduar me date 14.08.2016)** qe do te thotë se referenca është e lëshuar para se te përfundon shërbimi gjë qe nuk mund te merret parasysh kjo kontrate sepse shërbimi sipas kontratës duhet te përfundon me date **14.08.2016** .

5. ProCredit Bank - 01.11.2015 - vazhdon te jete aktive dhe pa ndërprerje,

Pas sqarimeve te ofruara nga OE ankues eksperti konstaton se kontrata e ofruar ne mes te **OE dhe ProCreditBank është e nënshkruar me date 01 Nëntor 2015 deri me date 31 Tetor 2016** për sigurimin fizik,por kjo kontrate ka edhe shërbime tjera si shërbime te transportit te parave etj te cilat nuk kane vlere te caktuar dhe atë për shërbime te ndryshme dhe jo siç është kërkuar vetëm për sigurim fizik si dhe ka sjellë raport financiar nga shërbimi i kontabilitetit te kompanisë por qe këto shuma nuk mund te dihen se për cilat shërbime mund te jene ne ketë rast.

Shuma e paraqitur sipas raportit te kontabilitetit te kompanisë është 528,534.59 por qe nuk dihet se cilat janë shumat për sigurim fizik (sepse kjo kontrate ka te përfshira edhe shërbime tjera si shërbime te transportit te parave),pra **edhe kjo shume nuk mund te identifikohet sa a është për shërbime te sigurimit fizik siç është kërkuar ne dosje te tenderit**.

Vlen te ceket se për ketë kontrate ka ofruar dy referenca njëra është e datës 22.08.2016 ndërsa tjetra është e datës 20.07.2016 qe do te thotë se te dy referencat janë lëshuar para se te përfundon shërbimi sepse kontrata përfundon me date 31.10.2016 dhe po ashtu referenca e datës 20.07.2016 shpjegon se kontrata përmban edhe shërbime tjera e jo vetëm sigurim fizik.

Sqarimi 3.

Duke analizuar ofertën e OE ankues Besa Security ,sqarimet shtese te kërkuara nga AK-UP dhe sqarimet tjera te kërkuara nga eksperti vijmë ne konkludim se ky OE nuk e përmbush kriterin per qarkullim financiar prej 3,000,000.00 euro për sigurim fizik te dëshmuara me kontrata dhe referenca te përfunduara ,sepse edhe pas sqarimeve verbale dhe dëshmive te sjellura ne forme fizike nuk mund ta dëshmoj ketë qarkullim,po ashtu nuk ka sjellë dëshmitë sipas kërkesave te dosjes se tenderit,ka sjell referenca me data para se me përfundua shërbimet,mandej disa nga shërbimet janë te një natyre tjetër dhe përmes raporteve financiare te kontabilitetit te kompanisë assesi nuk mund te identifikohen shumat se për cilat shërbime janë dhe si konstatim i përgjithshëm është se ky OE nuk përmbush ketë kriter.

Prandaj eksperti mendon se AK UP e ka eliminuar ketë OE sepse nuk ka përmbush qarkullimin financiar dhe se pretendimet e OE ankues edhe pse nuk është cekur asnjë dispozite ligjore qe është shkelur nga AK janë te paqëndrueshme.

PERGJIEGJET E EKSEPRTIT TEKNIK NE LIDHJE ME PRETENDIMET ANKIMORE TE OE ANKUES me nr. 144/17 e OE "Rojet e Nderit" - Prishtinë

Sqarimi nr.4

Eksperti teknik duke u bazuar ne pretendimet e OE ankues sqaron se nuk vëren se ka ndodh ndonjëra nga shkeljet e neneve te cekura ne ankese.
Nëse analizojmë analizat financiare te dy OE,OE fitues (Rojet e Nderit) dhe atij ankues (Security Code) eksperti konstaton se te dy OE ne baze te kalkulimeve kane çmime te njëjta për ore pune.
Nëse marrim kalkulimet e OE fitues Rojet e Nderit ,analiza financiare tregon se te dy OE kane çmim te njëjte për ore pune dhe at 2.15 euro,po ashtu po qese marrim kalkulimet e OE ankues Security Code,analiza financiare tregon se te dy OE kane çmim te njëjte për ore pune dhe at 2.16 euro.

Pra OE ankues duke marre parasysh çmimin e uniformave për te dy OE qe ne ketë rast OE ankues ka çmimin prej 2.61 euro për uniforma ndërsa OE fitues ka çmimin prej 3.06 euro pretendon se do te duhej te jete me i lire se OE fitues mirëpo pas kalkulimeve te ekspertit për këta dy OE duke marre kalkulimet e njërit dhe tjetrit del se te dy OE kane çmime te njëjta për njësi.

Deri te kjo situate ka ardh për shkak se sipas LPP,konkretisht sipas udhëzuesit operativ-2016-A01_Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik,neni 18. Dosja e Tenderit, qmimi i ofertuar lejohet te shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore, çdo numër pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës. Ne rast se AK Lejon me shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet te ceke këtë decidivisht ne dosje te tenderit.

Rrjedhimisht nga ato qe u ceken me larte ekspertet mendojnë se AK ka zbatuar ne përgjithësi dispozitat ligjore te LPP dhe nuk ka bere shkelje te dispozitave ligjore për te cilat pretendon OE ankues Security Code.

Sqarimi 5.

Ne situatën kur dy OE kane çmim te njëjte te ofertës sipas udhëzuesit operativ-2016-A01_Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 40. Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve,pika 40.9 Ne rastet kur AK pranon dy apo me shume oferta te përgjegjshme me çmime te njëjta (identike) nuk vlen votimi i anëtarëve te komisioneve te vlerësimit për përzgjedhjen e OE,por përzgjedhja behet sipas kohës se dorëzimit te ofertës (OE i cili e ka dorëzuar ofertën i pari).

Bashkangjitur gjeni kalkulimet e OE ROJET E NDERIT DHE SECURITY CODE sipas formulave te njerës dhe tjetres kompani per te dy OE.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

Eksperti shqyrtues bazuar në sqarimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – UP-Universiteti i Prishtinës, për aktivitetin e prokurimit "**Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës**",me nr. te prokurimit **242-17-88-2-1-1**, Nr. i brendshëm: **90400-17-002-211**, i ka respektuar në përgjithësi dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,dhe duke u bazuar ne ato qe janë cekur me larte rekomandon Panelin Shqyrtues te refuzoj ankesat me nr. 140/17 te OE Besa Security dhe ankesën me nr. 144/17 te OE Security Code njëkohësisht te lejohet AK UP-Universiteti i Prishtinës te vazhdoj me tutje me procedurat e prokurimit.

ANALIZA FINANCIARE-ROJET E NDERIT SIPAS FORMULES SE SECURITY CODE

Për përmbushjen e kërkesës së AK për pagën **250€** Bruto të kërkuar duhet të i shtohet 5%(12.50€) e trustit pensional dhe pastaj të filloj kalkulimet tjera,dmth 262.50€ pjestuar për 174 orë=1.5086€,ora e dites.

1	Paga Bazë Bruto për punëtor e kërkuar nga AK-UP	**250.00€**
2	Tatimi për kontribut pensional nga punëdhënësi 5%	**+12.50€**
3	Shenzimet për pagen 250 bruto e punëtorit me trust pensional	**=262.50€**

1	Përqindja për një muaj për pushimin vjetor për të cilin kompania është e detyruar ti jap punëtorit me pagesë sipas nenit 32 të Ligjit Nr.03/L-212.	**(262.5/12)**	**21.87€**	Shpenzimet Bruto për një punëtor jan **262.50€** pjestur për **12 muaj**(një vitë) na del vlera e shpenzimeve mujore për një punëtor për pushim vjetor.
2	**109** orë të dites mesatare për një muaj.	**1.51€x109orë=164.59€**		**Ora e dites.(262.50/174=1.51)**
3	**59** orë të nates mestare për një muaj.	**1.96€x 59orë =115.64€**		**Ora e nates.(262.50/174=1.51+30%=1.96)**
4	**6** orë të festave mesatare në muaj .	**2.26€x 6 orë = 13.56€**		**Ora e festes.(1.51x50%=2.26)**
5	**174 orë fondi i orëve për një punëtor.**	**174orë**		Sipas Ligjit në fuqi dhe Udhëzimit Adminstrativ **MPMS Nr.09/2013** dhe kerkeses se AK-UP.
6	Totali i kostos më të gjitha obligimet .		**315.66€**	**Pa tvsh vetëm për mbulimin e pagave dhe pushimin vjetor.**
7	Fitimi i kompanisë.		**0.10€**	Fitmi për një punëtor.
8	Shpenzimet për uniform –Verë/Dimer.		**3.06€**	Çmimi i uniformës të komp."**Rojet e Nderit**"është **0.81+2.25=3.06€** pa TVSH.
9	Totali pa tvsh.		**318.82€**	
10	Vlera e TVSH.		**57.39€**	Çmimi i ofertuesit PLUS 18% TVSH.
11	Oferta e OE e pjestuar për 174 orë pune		**376.21€**	Për një punëtor 174 orë pune.
12	Qmimi për një orë pune/njësi.		**2.16€**	
13	Totali i pergjegjeshum i ofertes më tvsh.		**1,542,758.40€**	**2.16€**(një orë pune) **x 714240 orë pune.**

Festat zyrtare brenda një muaji për një punëtor	
Festat zyrtare në RKS 12 ditë brenda një viti	288 orë
Mesatarja një festë në muaj pjestuar per 4 Roje	24orë
Orët e punës për një punëtor	6orë
Çmimi ores të dites+ 50 % sipas LP neni 56 për festa zyrtare	2.26€
Shpenzimet për një punëtor për orët e nates për një muaj	13.56€

Netët brenda një muaji për një punëtor			
Kosto e Pagës bazë për një punëtor me 5% trust pensional te punedhenesit	262.50	244orë	8 Orë nate herë mesatarja e një muaji 30+31/2=30.5ditë minus një feste=29.5 ditë
Orët e punës për një punëtor	174	236orë	29.5 herë 8 orë nate=236 orë e natës pjestuar për 4 Roje=59 orë të nates
Çmimi për një orë pune të dites	**1.51€**	59 Orë	Zbritja sipas paragrafit 3 8 ,6 orët e festave paguhen me 50% jo me 30%
Çmimi ores të dites + 30 % sipas LP neni 56		**1.96€**	Orët e natës për një punëtor
Shpenzimet për një punëtor për orët e nates për një muaj	115.64€		

KOMPANIA E SIGURIMIT FIZIK
SECURITY CODE
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RR.MUHARREM FEJZA BLL. III, HY.4, LOKALI 15-1
10.000 PRISHTINË REPUBLIKA E KOSOVËS

038 551 941 | 045 233 500 | info@seccode.org

ANALIZA FINANCIARE-SECURITY CODE

Për përmbushjen e kërkesës së AK për pagën **250€** Bruto të kërkuar duhet të i shtohet 5%(12.50€) e trustit pensional dhe pastaj të filloj kalkulimet tjera,dmth 262.50€ pjestuar për 174 orë=1.5086€,ora e dites.

1	Paga Bazë Bruto për punëtor e kërkuar nga AK-UP	**250.00€**
2	Tatimi për kontribut pensional nga punëdhënësi 5%	**+12.50€**
3	Shenzimet për pagen 250 bruto e punëtorit me trust pensional	**=262.50€**

1	Përqindja për një muaj për pushimin vjetor për të cilin kompania është e detyruar ti jap punëtorit me pagesë sipas nenit 32 të Ligjit Nr.03/L-212.	**(262.5/12)**	**21.87€**	Shpenzimet Bruto për një punëtor jan **262.50€** pjestur për **12 muaj**(një vitë) na del vlera e shpenzimeve mujore për një punëtor për pushim vjetor.
2	**109** orë të dites mesatare për një muaj.	1.51€x109orë=164.59€		**Ora e dites.(262.50/174=1.51)**
3	**59** orë të nates mestare për një muaj.	1.96€x 59orë =115.64€		**Ora e nates.(262.50/174=1.51+30%=1.96)**
4	**6** orë të festave mesatare në muaj .	2.26€x 6 orë = 13.56€		**Ora e festes.(1.51x50%=2.26)**
5	**174 orë fondi i orëve për një punëtor.**	174orë		Sipas Ligjit në fuqi dhe Udhëzimit Adminstrativ **MPMS Nr.09/2013** dhe kerkeses se AK-UP.
6	Totali i kostos më të gjitha obligimet .		315.66€	**Pa tvsh vetëm për mbulimin e pagave dhe pushimin vjetor.**
7	Fitimi i kompanisë.		0.10€	Fitmi për një punëtor.
8	Shpenzimet për uniform –Verë/Dimer.		2.61€	Çmimi i uniformës të komp."**Security Code**"është **2.61€** pa TVSH.
9	Totali pa tvsh.		318.37€	
10	Vlera e TVSH.		57.31€	Çmimi i ofertuesit PLUS 18% TVSH.
11	Oferta e OE e pjestuar për 174 orë pune		375.68€	Për një punëtor 174 orë pune.
12	Qmimi për një orë pune/njësi.		2.16€	
13	Totali i pergjegjeshum i ofertes më tvsh.		1,542,758.40€	**2.16€**(një orë pune) **x 714240 orë pune.**

Festat zyrtare brenda një muaji për një punëtor	
Festat zyrtare në RKS 12 ditë brenda një viti	288 orë
Mesatarja një festë në muaj pjestuar per 4 Roje	24orë
Orët e punës për një punëtor	6orë
Çmimi ores të dites+ 50 % sipas LP neni 56 për festa zyrtare	2.26€
Shpenzimet për një punëtor për orët e nates për një muaj	13.56€

Netët brenda një muaji për një punëtor			
Kosto e Pagës bazë për një punëtor me 5% trust pensional te punedhenesit	262.50	244orë	8 Orë nate herë mesatarja e një muaji 30+31/2=30.5ditë minus një feste=29.5 ditë
Orët e punës për një punëtor	174	236orë	29.5 herë 8 orë nate=236 orë e natës pjestuar për 4 Roje=59 orë të nates
Çmimi për një orë pune të dites	**1.51€**	59 Orë	Zbritja sipas paragrafit 3 8 ,6 orët e festave paguhen me 50% jo me 30%
Çmimi ores të dites + 30 % sipas LP neni 56		**1.96€**	Orët e natës për një punëtor
Shpenzimet për një punëtor për orët e nates për një muaj	115.64€		

KOMPANIA E SIGURIMIT FIZIK

SECURITY GUARD COMPANY

"ROJET E NDERIT" SH.P.K

Tel: 0800-88-666
Mob: 044 / 373-321,
049/ 80 40 70

web: www.ksf-rojetenderit.com
info@rojetenderit.com
Adresa:Rr.GjergjBalshajArbëripn,
10000 Prishtinë /Kosovë

Prishtinë 31 maj 2017

Pershendetje i nderuar,

Analiza financiare e kalkulimit të pagës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues Univeristeti i Prishtinës "Hasan Prishtina", kalkulimi është bazuar në të gjitha bazat ligjore, dhe sipas sistemit të Administratës Tatimore të Kosovës.

Tabela e detajizuar :

ANALIZA FINANCIARE		SQARIM
PAGA BRUTO	250.00	
ORET E NATËS	22.85	(ORET E NATES)
PUSHIMI VJETOR	22.08	Paga Bruto + Trusti Pensional I Punëdhënsit/ 12 muaj.
FESTAT	4.11	(FESTA)
PAGA TOTALE PËR NJË PUNËTORË PA TRUST	**299.04**	Paga bruto+oret e nates+pushimi vjetor+festat.
TRUSTI PENSIONAL I PUNËDHËNËSIT	14.95	(=299.04*5%/100)
PAGA TOTALE PER NJË PUNETORË PA UNIFORMA DHE PA TVSH	**313.99**	(=299.04+14.95)
UNIFORMA E VERËS	0.81	(9.70 EURO PJESTUAR ME 12 MUAJ = 0.81)
UNIFORMA E DIMRIT	2.25	(27.00 EURO PJESTUAR ME 12 MUAJ = 2.25)
FITIMI I PARASHIKUAR	0.10	(FITIMI I PLANIFIKUAR)
PAGA TOTALE PER NJE PUNËTORË PA TVSH	**317.15**	**(TOTALI I PAGES PA TVSH)**
TVSH-ja	57.08	(TVSH)
PAGA TOTALE PËR NJË PUNETORË ME TVSH	374.23	(TOTALI ME TVSH)
QMIMI PËR ORE PUNE = 374.05/174 ORË	**2.15**	**(TOTALI = 374.18 EURO/174=2.15 ORE E PUNES)**

Me respekt,
Arben Hasani
Zyra për Qeshtje Finaciare

Kontakt:
Mob. 044 258585, 049 787896

ANALIZA FINANCIARE PER OE SECURITY CODE SIPAS FORMULES SE OE ROJET E NDERIT

ANALIZA FINANCIARE		SQARIM
PAGA BRUTO	250.00	
ORET E NATËS	22.85	(ORET E NATES)
PUSHIMI VJETOR	22.08	Paga Bruto + Trusti Pensional I Punëdhënsit/ 12 muaj.
FESTAT	4.11	(FESTA)
PAGA TOTALE PËR NJË PUNËTORË PA TRUST	**299.04**	Paga bruto+oret e nates+pushimi vjetor+festat.
TRUSTI PENSIONAL I PUNËDHËNËSIT	14.95	(=299.04*5%/100)
PAGA TOTALE PER NJË PUNETORË PA UNIFORMA DHE PA TVSH	**313.99**	(=299.04+14.95)
UNIFORMA E VERËs + DIMRIT	2.61	(31.32 EURO PJESTUAR ME 12 MUAJ = 2.61)
FITIMI I PARASHIKUAR	0.10	(FITIMI I PLANIFIKUAR)
PAGA TOTALE PER NJE PUNËTORË PA TVSH	**316.70**	**(TOTALI I PAGES PA TVSH)**
TVSH-ja	57.01	(TVSH)
PAGA TOTALE PËR NJË PUNETORË ME TVSH	373.71	(TOTALI ME TVSH)
QMIMI PËR ORE PUNE = 374.05/174 ORË	**2.15**	**(TOTALI = 373.71 EURO/174=2.15 ORE E PUNES)**